



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L- 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2020, merr këtë

VENDIM
PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË AKSIONARËVE TË NËDRMARRJEVE
PUBLIKE LOKALE

- I. MIRATOHET Vendimi për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës.
- II. Aksionarët do të kompensohen për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të ndërmarrjes publike lokale ku të njëjtit shërbejnë.
- III. Mjetet për kompensimin e aksionarëve do të merren nga Komuna e Prishtinës.
- IV. Ky vendim vlenë vetëm për aksionarët e zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, përderisa kompensimin e aksionarëve të deleguar të Kryetarit të Komunës, këtij të fundit i rekomandohet ta rregulloj me një vendim të veçantë.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0210515/20, më 13.11.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

I Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale.

Për shkak të përgjegjësive të mëdha ligjore që ngarkojnë mbi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që shërbejnë në komisionet komunale të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe punës shtesë që këta persona janë të detyruar ta bëjnë në kuadër të këtyre përgjegjësive është vlerësuar edhe që të njëjtit të kompensohen ashtu edhe si është paraparë në dispozitiv të këtij vendimi.

